Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.8 Tarifa e pagesave për Liçensa, Çertifikata për Transport Rrugor, aplikohen sipas pasqyrës së miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr.13786/1 ,datë 27.01.2010.

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

II.9 Tarifa e parkimi për mjetet e liçensuara dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë:



II.9.1 Tarifë për parkimin për çdo mjet të licënsuar :

Kategoritë	Njësia	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	19 500
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	15 600
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/vit/mjet	11 700
Tarifë për autoveturë taxi 8+1 vende	Lekë/vit/mjet	7 800
Tarifë për autoveturë taxi 6+1 vende	Lekë/vit/mjet	5 800
Tarifë për autoveturë taxi 4+1 vende	Lekë/vit/mjet	3 900
Tarifë parkimi për automjete transporti mallrash që licënsohen, ose çertifkohen		
Tarifë për Kamionë	Njësia	Tarifa
• Me kapacitet maksimal transportues deri në 3,5 ton	Lekë/vit/mjet	3 900
• Me kapacitet maksimal transportues 3,5 deri në 8 ton	Lekë/vit/mjet	5 800
• Me kapacitet maksimal transportues 8 deri në 14 ton	Lekë/vit/mjet	7 800
• Me kapacitet maksimal transportues mbi 14 ton	Lekë/vit/mjet	9 700

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.9.2 Tarifa e parkimit për mjetet që çertifkohen për transport udhëtarësh për llogari të vet, të cilët nuk kanë stacion qëndrimi me pagesë:

Tabela e mëposhtme:

Kategoritë	Njësia	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	5 000
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	4 000
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/vit/mjet	2 000
Tarifë për mikrobuza taxi 8+1 vende	Lekë/vit/mjet	1 000

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.9.3 Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë / transport udhëtarësh :

Kjo tarifë do të zbatohet në zonën A dhe në fshatin Tushemisht të NJA Buçimas:



Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë/transport udhëtarësh	Njësi	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/orë	150
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25 vende	Lekë/orë	100
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/orë	100
Tarifë për autoveture 8+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për autoveture 6+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për autoveture 4+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për parkim për automjetet që qëndrojnë në afërsi të Tregjeve të miratuara nga NJA Çërravë dhe Proptisht	Lekë/muaj	200

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.9.3.1 Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë:

Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë/transport udhëtarësh	Njësi	Tarifa
Tarifë për automjetet në parkimet me pagesë në Bashkinë Pogradec	Lekë/orë	50
Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjekte	Lekë/Vit	36000
Tarifë për parkim për banorët rezidente pranë banesës së tyre	Lekë/ Vit	1000

Harta e ndarjes për parkimet e rezidentëve bashkëngjitur vendimit.

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon shoqërisë "Pogradec Invest" shpk ,vjelja kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.9.4. Tarifë parkimi tek terminali i autobusave:

Tarifë parkimi në vendparkime ne terminalin	Njësi	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/orë	200
Tarifë për autobuza 9+1 deri 25+1 vende	Lekë/orë	150
Tarifë për autoveture 8+1 vende për mjete në linja rrethqytetëse	Lekë/orë	100

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon shoqërisë "Pogradec Invest" shpk ,vjelja kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.9.5. Tarifa për librat e udhëtimit për shërbime turistike / të rastit të udhëtarëve brenda vendit :



Tarifa për librat e udhëtimit	Njësi	Tarifa
Libri i udhëtimit me 25 fletë me ngjyrë të gjelbër e lehtë	Lekë/libër	12 500

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.10 Tarifat për Shërbimet në Bashkinë Pogradec:

Tarifë për Shërbimet	Njësia	Pogradec, Buçimas, Udënisht	Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebijnjë
Tarifë për vërtetim që jepet nga arkivi i Bashkisë	Lekë	200	50
Tarifë për fotokopje të dokumentave të arkivit (për privatë), nën 5 faqe	Lekë	200	0
Tarifë për fotokopje të dokumentave të arkivit (për private) mbi 5 faqe (+10 lekë për çdo faqe shtesë)	Lekë	200	0
Tarifë për studimin e dokumentave të arkivit (për privatë)	Lekë	300	0
Tarifë për dhënie e formularit të lejës dhe çertifikatës së transportit të mallrave	Lekë	200	0

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Drejtorive përkatëse që ofrojnë shërbimin ,ndërsa vjelja e këtij detyrimi kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.11 Tarifat për Dhënie Lejë për Ushtrim Aktiviteti :

Të gjitha Lejat do të jepen në bazë të kërkesës me shkrim nga i interesuari.

Kategoria	Njësia	Pogradec	Buçimas, Udënisht	Çërravë	Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebijnjë
Tarifë për zgjatje orari të kohës normale të punës për Bar-Bufe, Restorante, Pub & Disko	Lekë/muaj	5 000	5 000	0	0
Tarifë për zgjatje orari të kohës normale të punës për Lojra e Fatit	Lekë/muaj	10 000	10 000	0	0
Tarifë për leje veprimtarie 24 orë për Bar-Bufe, Resorantr, Pub & Disko	Lekë/muaj	8 000	8 000	0	0



Tarifë për autorizim për pikë shitje lëndë djegëse për nevoja familjare	Lekë/muaj	5 000	2 000	1 000	
Tarifë Servis, riparim mjetesli transporti, Shërbim Rimorkim mjetesli të difektuara në rrugë, Shërbim Lavazh mjetesli, Gomisteri.	Lekë/muaj	5 000	5 000	5 000	3 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.11.1 Tarifat për dhënie e Liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj :

Bazuar në Vendim nr.344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj",

Kategoria	Njësia	Pogradec	Buçimas, Udënisht	Cërravë	Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebinjë
Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçensave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajnat lubrifikante	Lekë/5 vjet	1 000 000	1 000 000	1 000 000	1 000 000
Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçensave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ashtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.	Lekë/5 vjet	100 000	100 000	100 000	100 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Bankave të Nivelit të II-të.

II.12 Tarifat për Lejë për veprimtari të përkohshme :

Tarifë për pistë makinash elektrike etj.	Njësia	Pogradec	Buçimas, Udënisht
Tarifë për pistë makinash elektrike etj në pronë publike	Lekë	10 000	10 000
Tarifë për lodra elektrike në pronë publike	Lekë	5 000	5 000
Tarifë për lodra me bateri për fëmijë në pronë publike	Lekë	5 000	5 000



Tarifë për leje për bar-shërbime në pronë publike	Lekë	15 000	15 000
Tarifë për leje për bar-shërbime në pronë jo publike	Lekë	50 000	50 000
Tarifë për leje për vendosje objektesh të përkohëshme për aktiviteti tregtar në pronë publike (panaire, promocione, spektakle, etj.)	Lekë	5 000	5 000

Detyrimi për llogaritjen e vjeljen e saj të bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.13 Tarifat për ndikimin në mjedis:

Kategoria	Njësi	Bashkia
Tarifë për ndikimin në mjedis në Bashki dhe Njësitë administrative (ndotje nga incerte, karburante, etj)	Lekë/vit	20 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarifë kryhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.14. Menaxhimi i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës ujitëse nga OPU-të bëhet nga Bashkia Pogradec mbështetur në Ligjin nr.24/2017, "Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit".

II.14.1 Tarifa e shërbimit të ujitjes :

Tarifa e shërbimit të ujitjes	Njësi	Tarifa
Për ujitjen me gravitet (me rrjedhje të lirë)	Lekë/dylym/ujitje	300
Për ujitjen me ngritje mekanike me pompa individuale	Lekë/dylym/ujitje	200

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.14.2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes :

Tarifa e vjetore e mirëmbajtjes (ujitje – kullim)	Njësi	Tarifa
Për zonën e ulët (Nj.Ad.Çerrave,Dardhas,Buçimas,Udënisht)	Lekë/dylym/vit	300
Për zonën e lartë (Nj.Ad lartë (Nj.Ad.Velçan,Trebinjë,Proptisht)	Lekë/dylym/vit	200



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.15 Tarifa për hyrjen në muze:

Nr.	Kategoria	Njësia	Vlera
1.	Bileta për vizitorë vendas	Lekë/person	100
2.	Bileta për vizitorët e huaj	Euro/person	1
3.	Bileta për nxënësit e shkollave	Lekë/person	50

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Turizmit, Trashëgimisë Kulturës dhe Rinisë.

II.16 Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe:

Tarifë për kopshtet	Njësi	Vlerë
Tarifë për kopshte	Kuota mujore lekë/fëmije	3960
Tarifë për çerdhet	Njësi	Vlerë
Tarifë për çerdhet	Kuota mujore lekë/fëmije	3300

Detyrimi për vjeljen e kësaj tarife i takon Degës Ekonomike të Qendrës Ekonomike të Arsimit dhe pagesa kryhet pranë Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.17 Tarifat për shpenzimet e varrimit :

Tarifë për shpenzimet e varrimit	Njësi	Qyteti Pogradec	Buçimas,Udënisht, Çërravë	Proptisht Velçan Trebinajë Dardhas
Tarifë për shpenzime varrimi për të rritur	person	14 000	7 000	5 000
Tarifë për shpenzime varrimi për të vegjël	person	7 000	3 500	2 000
Tarifë për shpenzime zhvarrimi	person	7 000	3 500	2 000
Tarifë për shpenzime zhvarrim dhe varrimi	person	15 000	7 500	5 500



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Degës Ekonomike të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike.

II.18 Tarifa aplikimi për kalim pronësie të ndërtesave të ndërtuara para datës 10.8.1991 :

Tarifë për aplikimin për ndërtesat e ndërtuara para 1991	Njësi	Vlerë
Tarifë aplikimi për ndërtesa të ndërtuara para datës 10.8.1991 në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec	Lekë/aplikim	5000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.1 Tarifë për planet e detajuara vendore :

Tarifa për PPV paguhet nga investitori, me një këst të vetëm, para pajisjes me lejë lejë ndërtimi :

Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Pogradec	Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht Velçan Trebinjë Dardhas
III.2.1 Për objekte përpara pajisjes me lejë ndërtimi	Në % sipas vlerës së preventivit	1	1	1	1
III.2.2 Për çdo objekt që legalizohet	Në % sipas vlerës së preventivit	1	1	1	1

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.2 Tarifa aplikimi :

Sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", neni 15, pika "F", një nga dokumentat që duhet të dorëzojë aplikuesi për lejë ndërtimi është mandatpagesa /të tarifave të aplikimit.



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të Dytë.

III.2.1 Tarifa e aplikimit për Lejë ndërtimi:

Kategoria	Njësia	Pogradeç Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht Velçan Trehinjë Dardhas
1. Për objekte ,banesa kolektive,biznesi, hoteleri dhe shtesa mbi 250 m ²	Lekë	100000	30000	10000
2. Për objekte banimi dhe shtesa deri në 250 m ²	Lekë	10000	3000	2000
2.1 Për objekte banimi individuale dhe shtesa mbi 250 m ²	Lekë	20000	6 000	4 000
3. Për objekte biznesi, hoteleri dhe shtesë deri në 250m ²	Lekë	40 000	20000	10000
4.Për objekte në infrastrukturë	Lekë	100000	100000	100000
5.Për objekte të tjera	Lekë	5000	2000	1000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.3 Tarifa e aplikimit për Lejë ndërtimi, për riparim, restaurim, rikonstruksion:

Kategoria	Njësia	Pogradeç Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht Velçan Trehinjë Dardhas
1 Për objekte banimi mbi 250 m ²	Lekë	20 000	10 000	5 000
2 Për objekte banimi deri në 250 m ²	Lekë	5 000	2 000	1 000
3 Për objekte biznesi, hoteleri	Lekë	20 000	10 000	5 000
4 Për objekte në infrastrukturë	Lekë	40 000	20 000	10 000
5 Për objekte të tjera	Lekë	3 000	1 000	500

Sqarim: Riparaqitja e kërkesës për leje ndërtimi, pas mospranimit ose refuzimit të saj, trajtohet si kërkesë e re, pa detyrimin e ripagesës së tarifës së aplikimit. (sipas ndryshimeve të "Rregullores së zhvillimit të territorit" miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 408, date 13.05.2015 (i ndryshuar).



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhetnëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.4 Tarifa e aplikimit për lejë prishje :

Kategoria	Njësia	Pogradec	Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht ,Velçan Trebijnjë,Dardhas
1. Për objekte banimi mbi 250 m ²	Lekë	20000	10000	5 000	3000
2.Për objekte banimi deri në 250 m ²	Lekë	10000	5000	2000	1 000
3. Për objekte të tjera	Lekë	5 000	3000	1 000	500

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhetnëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.5 Tarifa e aplikimit për kryerje punimesh me deklaram paraprak për punime me vlerë preventivi deri në 1 000 000 lekë:

Kategoria	Njësia	Vlera
1. Njësia administrative Pogradec, Buçimas , Udënisht	Lekë	5000
2. Njësia administrative Çërravë	Lekë	2000
3 .Njësia administrative Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	Lekë	1000

**Për punime me vlerë preventivi mbi 1 000 000 lekë, tarifat e mësipërme dyfishohet.*

**Për të njëjtin zhvillues dhe objekt aplikimi në të njëjtën pasuri pagesa të kryhet vetëm një here, për tre aplikime për një periudhe kohore 90 ditë kalendarike.*

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhetpranë Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.6 Tarifa e aplikimit për shtyrje afati Lejë ndërtimi :



Kategoria	Njësia	Pogradec, Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht ,Velçan Trebinjë, Dardhas
1. Për objekte banimi mbi 250 m ²	Lekë	10000	6000	2000
2. Për objekte banimi deri në 250 m ²	Lekë	5000	2000	1000
3 .Për objekte biznesi, hoteleri	Lekë	8000	6000	2000
4 .Për objekte në infrastrukturë	Lekë	10000	6000	4000
5 .Për objekte të tjera	Lekë	500	500	200

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.7 Tarifë aplikimi për ndryshim të subjektit ndërtues/zhvillues dhe për ndryshim të aktiviteteve dhe funksionit të njësive individuale:

Kategoria	Njësia	Vlera
1. Njësia administrative Pogradec, Buçimas, Udënisht	Lekë	5000
2 .Njësia administrative Çërravë	Lekë	3000
3 .Njësia administrative Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	Lekë	2000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.8 Tarifë aplikimi për lejë zhvillimi :

Kategoria	Njësia	Vlera Kur leja e zhvillimit del si rezultat i PDV	Vlera Kur leja e zhvillimit nuk del si rezultat i PDV
1. Njësia administrative Pogradec	Lekë/m ²	10	20
2 .Njësia administrative Buçimas, Udënisht	Lekë/m ²	8	15
3.Njësia administrative Çërravë	Lekë/m ²	5	10
4 .Njësia administrative Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	Lekë/m ²	5	10

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.



**Për të njëjtin zhvillues dhe objekt aplikimi në të njëjtën pasuri, pagesa të kryhet vetëm një herë.*

III.9 Tarifa e aplikimit për rishikimin e kushteve të lejës :

Kategoria	Njësia	Pogradec Buçimas Udënisht	Çerravë	Proptisht Velçan Trebinjë Dardhas
1. Për objekte banimi mbi 250 m ²	Lekë	10000	6000	4000
2. Për objekte banimi deri në 250 m ²	Lekë	5000	2000	1000
3 .Për objekte biznesi, hoteleri	Lekë	8000	6000	4000
4. Për objekte në infrastrukturë	Lekë	10000	6000	4000
5. Për objekte të tjera	Lekë	3000	1000	500

Sipas nenit 48 (Rishikimi i kushteve të lejës së ndërtimit) të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe nenit 17 të VKM nr.408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.10 Tarifë për sipërfaqe fasade :

Kategoria	Njësia	Pogradec Buçimas Udënisht	Çerravë	Proptisht Velçan Trebinjë Dardhas
1. Për objekte banimi mbi 250 m ²	Lekë/m ²	100	50	30
2. Për objekte banimi deri në 250 m ²	Lekë/m ²	40	20	10
3 .Për objekte biznesi, hoteleri	Lekë/m ²	100	50	30
4. Për objekte të tjera	Lekë/m ²	40	20	10

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.11 Tarifë aplikimi për transferim të të drejtës për zhvillim për të gjitha Njësitë Administrative : 5 000 lekë



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.12 Tarifa shërbimi në Arkivin teknik :

Kategoria	Njësia	Vlera
1.Studim i dokumentacionit në arkiv për subjektet private	Lekë	500
2 .Fotokopje të dokumentave të arkivit , për subjektet private, format A4	Lekë/copë	100
3 .Fotokopje të dokumentave të arkivit , për subjektet private format A3	Lekë/copë	200
4 .Vërtetime nga arkivi për subjektet private	Lekë	500

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.13 Tarifa e aplikimit për Çertifikatë Përdorimi :

Kategoria	Njësia	Vlera
1. Për ndërtime të reja Njësia administrative Pogradec, Buçimas,Udënisht objekte banimi shumë katëshe shumë familjare,objekte biznesi,hoteleri	Lekë	20000
2. Për ndërtime të reja Njësia administrative Pogradec, Buçimas,Udënisht objekte banimi individuale	Lekë	10000
3 Për ndërtime të reja Njësia administrative Çërravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë,objekte banimi shumë katëshe shumë familjare,objekte banimi,hoteleri	Lekë	10000
4.Për ndërtime të reja Njësia administrative Çërravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë, objekte biznesi individuale	Lekë	5000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.



III.14 Tarifa e aplikimit për Çertifikatë Përdorimi për ndërtime në rikonstruksion, riparim dhe restaurim :

Kategoria	Njësia	Vlera
1.Njësia administrative Pogradec	Lekë	8000
2 .Njësia administrative Buçimas,Udënisht	Lekë	6 000
3 .Njësia administrative Çërravë	Lekë	4000
4.Njësia administrative Proptisht,Velçan, Trebinjë.	Lekë	2000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.15 Tarifa e aplikimit për Çertifikatë Përdorimi për mirëmbajtje të jashtëzakonshme:

Kategoria	Njësia	Vlera
1.Njësia administrative Pogradec	Lekë	8000
2.Njësia administrative Buçimas,Udënisht	Lekë	6000
3.Njësia administrative Çërravë	Lekë	4000
4.Njësia administrative Proptisht,Velçan, Trebinjë	Lekë	2000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.16 Tarifa e aplikimit për Çertifikatë Përdorimi për punime infrastrukturë:

Kategoria	Njësia	Vlera
1.Njësia administrative Pogradec	Lekë	10000
2.Njësia administrative Buçimas,Udënisht	Lekë	8000
3.Njësia administrative Çërravë	Lekë	5000
4 .Njësia administrative Proptisht,Velçan, Trebinjë,	Lekë	3000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.17 Tarifë për pajisje me Çertifikatë Përdorimi :



Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Pogradec	Buçimas/ Udënisht	Çërravë	NJA të tjera
1. Për objekte mbi 250m ²	Lekë/m ²	50	40	30	10
2. Për ndërtime rikonstruksion, riparim dhe restaurim mbi 250m ²	Lekë/m ²	25	20	15	8
3. Për ndërtime për mirëmbajtje të jashtëzakonshme mbi 250m ²	Lekë/m ²	25	20	10	5
4. Përpunime në infrastrukturë mbi 250m ²	Në % për vlerë preventivi	0.08	0.06	0.04	0.03
5. Për objekte deri në 250m ²	Lekë/m ²	20	20	15	10
6. Për ndërtime rikonstruksion, riparim dhe restaurim deri në 250m ²	Lekë/m ²	15	15	10	8
7. Për ndërtime për mirëmbajtje të jashtëzakonshme deri në 250 m ²	Lekë/m ²	20	20	15	8

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.18 Tarifa për aktet e kontrollit për objekte mbi 250 m² :

Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Pogradec	Buçimas/ Udënisht	Çërravë	Nj.A të tjera
1. Akt pikeitimi + plan pikeitimi	Lekë	10 000	5000	4000	2 000
2. Akt i përfundimit të themeleve	Lekë	10000	5000	4000	2000
3. Akt kontrolli i kuotës ± 0.00	Lekë	10000	5000	4000	2000
4. Akt përfundimi i karabinasë	Lekë	10000	5000	4000	2000
5. Akt përfundimi i fasadës	Lekë	10000	5000	4000	2000
6. Akt përfundimi i sistemimeve + plani i sisteme (rrjeti rrugor, sip. gjelberuar)	Lekë	12000	5000	4 000	2000
7. Akt kontrolli për zbatimin e punimeve (për zgjatje të afatit, rishikimit të kushteve lejës)	Lekë	15000	5000	5000	2000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.



II.19 Verifikim i Gen Planit / Planimetri :

Kategoria	Njësia	Vlera
1.Për lehtë zhvillimi/ndërtimi	Lekë	5000
2.Për lehtë për ndërtim të përkohshëm	Lekë	2500
3.Për deklarim paraprak	Lekë	3000
4. Për lehtë përdorimi	Lekë	3000
5. Për pretendim pronësie	Lekë	3000
6. Për informacion rreth vendndodhjes të pronës	Lekë	1000
7. Për vërtetim mbi vendodhjen e pronës brenda zonës urbane	Lekë	3000
8. Për vërtetim nqs objekti është ndërtuar para vitit 1991	Lekë	3000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.20 Tarifa për aktet e kontrollit për objekte deri në 250 m² :

Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Pogradec	Buqimas/ Udënisht	Çërravë	Nj.A të tjera
1.Akt piketimi + plan piketimi	Lekë	3000	3000	2000	1 000
2. Akt i përfundimit të themeleve	Lekë	3000	3000	2000	1000
3. Akt kontrolli i kuotës ± 0.00	Lekë	3000	3000	2000	1000
4. Akt përfundimi i karabinasë	Lekë	3000	3000	2000	1000
5. Akt përfundimi i fasadës	Lekë	3000	3000	2000	1000
6.Akt përfundimi i sistemimeve + plani i sisteme (rjeti rrugor,sip.gjelb)	Lekë	5 000	4000	3000	2000
7. Akt kontrolli për zbatimin e punimeve (për zgjatje të afatit,rishikimit të kushteve lejës)	Lekë	5000	4000	3000	2000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.21 Fotokopjimi i planshetave në shkallën 1/500, 1/2000 :



Kategoria	Njësia	Vlera
1) Formati A4	Lekë	200
2) Formati A3	Lekë	300

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.22 Tarifa e aplikimit :

Kategoria	Njësia	Vlera
1. Tarifë për Njoftim Fillim Punimesh	Lekë	1000
2. Tarifë për Njoftim për Raportin Final të Mbikqyrje Kolaudimin	Lekë	3000
3. Tarifë për ndryshimin e subjektit zbatues	Lekë	3000
4. Tarifë për kryerje punimesh që nuk kërkojnë pajisje me lehtë ndërtimi, ose deklarate paraprake për bizneset.	Lekë	2000
5. Tarifë për kryerje punimesh që nuk kërkojnë pajisje me lehtë ndërtimi, ose deklarate paraprake për familjet.	Lekë	1000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

III.23 Tarifa për depozitimin e mbetjeve inerte:

Kategoritë	Njësia	Për Bashkinë Pogradec
Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte sipas preventivit për gjurmime,prishje,sistemim,etj për banesa kolektive	Lekë	200 m ³
Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte sipas preventivit për gjurmime,prishje,sistemim,etj për çdo lloj ndërtimi.	Lekë	100 m ³

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

2.Zyrat në Bashkinë Pogradec nuk ofrojnë shërbim nëse dokumentacioni i kërkesës nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili konfirmon pagesën e taksave dhe tarifave vendore.



3. Shfuqizimin e të gjitha vendimeve të mëparshme të Këshillit Bashkiak, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" ,i ndryshuar).

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2023

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin "Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Pogradec".

I nderuar Kryetar i Këshillit!
Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Pogradec sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 61.530 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil të këtij viti ka 90.976 banorë,

Pjesa më e madhe e popullsisë së bashkisë, rreth rreth 56% është popullsi rurale.

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në Bashkinë Pogradec është 4.082 familje.

NDRYSHIME NË PAKETËN FISKALE 2024:

TAKSA E NDËRTESES:



Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Duke qënë se vlera e pronës është rritur në Bashkinë Pogradec dhe konkretisht në qytet si dhe fshatin Tushemisht, është menduar që taksa e ndërtesës të *rritet* për qytetin Pogradec dhe fshatin Tushemisht nga *26,45 lekë m²* në *32.43 lekë /m²*.

Kjo rritje është kryer bazuar në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar.

Sqarojmë se nuk ka ndryshuar çmimi referues prej 49 900 lekësh, por koeficienti është rritur nga 0.053 në 0.065 dhe për 1 m² përlllogaritja është $49\,900 * 0.065 \% = 32.43 \text{ lekë/m}^2$.

Konkretisht:

Në vitin 2023, një familje që banon në një apartament prej 100 m², paguante taksë ndërtesë 2645 lekë në vit,ose 220 lekë në muaj ose 7.3 lekë në ditë.

Për vitin 2024,një familje që banon në një apartament prej 100 m²,do të paguajë 3243 lekë në vit, ose 270 lekë në muaj, ose 9 lekë në ditë.

TARIFA E PASTRIMIT:

Tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë.

Kostot e Bashkisë Pogradec për shërbimin e pastrimit,grumbullimit dhe largimit në Landfill janë si më poshtë:

Kontrata e Pastrimit	116 000 000 lekë / vit
Kontrata me Lanfillin Maqil	28 454 000 lekë / vit
Total	144 454 000 lekë / vit



Aktualisht familjet dhe bizneset në Bashkinë Pogradec paguajnë vetëm koston e pastrimit, ndërsa koston e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në Landfill deri tani janë përballuar nga Bashkia. Ngarkesa tatimore ka qënë e shpërndarë 60 % tek familjet dhe 40% tek biznesi.

Për vitin 2024, Bashkia Pogradec, për shkak të rritjes të konsiderueshme të shpenzimeve, si paga dhe investime në infrastrukturë etje, ka vendosur që koston e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në Landfill të mos e përballojë më vetë, por t'ja ngarkojë familjeve dhe bizneseve në raport 55 % ngarkesë tatimore familjeve dhe 45 % të ngarkesës tatimore biznesit.

Parashikohet rritje si më poshtë:

Për familjet, tarifa e pastrimit rritet me 25 % për çdo banesë, ndërsa për shtëpi banimi me oborr deri në 100 m², rritet me 10 % ,si në Pogradec ashtu edhe për Njësitë Administrative dhe konkretisht:

Për çdo banesë në *Qytet* tarifa e pastrimit nga *3200 lekë* në vit që ishte *bëhet 4000 lekë* në vit. Për çdo shtëpi banimi me oborr deri në 100 m², në *Qytet* , tarifa e pastrimit nga *4000 lekë* në vit që ishte, *bëhet 4400 lekë* më vit.

Për çdo banesë në *Njësitë Administrative Buçimas dhe Udënisht*, tarifa e pastrimit nga *3200 lekë* në vit që ishte, *bëhet 4000 lekë* në vit.

Për çdo shtëpi banimi me oborr deri në 100 m², tarifa e pastrimit në *Njësitë Administrative Buçimas dhe Udënisht*, nga *4000 lekë* në vit që ishte, *bëhet 4400 lekë* më vit.

Për çdo banesë në *Njësinë Administrative Çërravë* , tarifa e pastrimit nga *2200 lekë* në vit që ishte, *bëhet 2400 lekë* në vit.

Për çdo shtëpi banimi me oborr deri në 100 m², tarifa e pastrimit në *Njësinë Administrative Çërravë* nga *2750 lekë* në vit që ishte, *bëhet 3000 lekë* në vit.

Për çdo banesë në *Njësitë e tjera Administrative*, tarifa e pastrimit nga *800 lekë* në vit që ishte, *bëhet 1100 lekë* në vit.

Për çdo shtëpi banimi me oborr deri në 100 m², tarifa e pastrimit në *Njësitë e tjera Administrative*, nga *1000 lekë* në vit që ishte, *bëhet 1100 lekë* më vit.

Konkretisht:



Një familje në Pogradec dhe në Njësitë Administrative Udënisht dhe Buçimas në vitin 2023, paguante 6800 lekë në vit tarifa vendore, në të cilat përfshihen: Tarifa e Pastrimit, Ndriçimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varrezash.

Pra, një familje në Pogradec paguante në muaj 567 lekë tarifa vendore ose 18,8 lekë në ditë.

Për vitin 2024, një familje në Pogradec dhe në Njësitë Administrative Udënisht dhe Buçimas do të paguajë 8000 lekë në vit tarifa vendore, ose 667 lekë në muaj ose 22,2 lekë në ditë.

Një familje në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2023, paguante 5300 lekë në vit tarifa vendore, ose 450 lekë më muaj ose 15 lekë në ditë .

Një familje në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2024, do të paguajë 6200 lekë në vit tarifa vendore, ose 517 lekë më muaj ose 17 lekë në ditë.

Një familje në Njësitë e tjera Administrative për vitin 2023 ,paguante 2800 lekë në vit tarifa vendore,ose 233 lekë më muaj ose 7,8 lekë në ditë.

Një familje në Njësitë e tjera Administrative për vitin 2024, do të paguajë 3100 lekë në vit tarifa vendore,ose 258 lekë më muaj ose 9 lekë në ditë.

***Konkretisht:** Një familje që banon në një banesë prej 100 m² në Pogradec, për vitin 2023, paguante në total taksa dhe tarifa vendore, 9046 lekë në vit, ose 754 lekë në muaj ose 25 lekë në ditë.*

Për vitin 2024, një familje në Pogradec që banon në një banesë prej 100 m² në total do të paguajë taksa dhe tarifa vendore, 11243 lekë në vit, ose 937 lekë në muaj ose 31 lekë në ditë.

TARIFA E PASTRIMIT PËR BIZNESIN:

Për të gjitha kategoritë e bizneseve që ushtrojnë veprimtari në Bashkinë Pogradec, tarifa e pastrimit *do të rritet 20%*, përveç kategorive më poshtë, të cilat gjenerojnë sasi mbetjesh më të mëdha, në përputhje me parimin "Ndotësi paguan", të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011 , "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar ,

- Prodhim (punime mobilerie punime druri, punime mermeri, fara e fidane, rritje shpendesh, rritje peshku, etj) prerje dhe tregtim dru zjarri për të cilën parashikohet *rritje prej 100%*.
- Parukeri, berber, estetike parashikohet *rritje prej 40%*
- Servis makinash *rritje prej 100%*.
- Bar-Restorant, Hotele, Agrobiznes, Fast-food *rritje prej 100%*.

- Bar-Kafe rritje prej 50%.

Bashkëlidhur Tabelat e tarifës së pastrimit për secilën kategori .

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Faleminderit!

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Esmeralda Topçiu

Pranoi: Klajdi Bizgjoni

Miratoi: Anxhela Piliçi

Konfirmoi: Dritan Babasli



Kategorisë e Biznesit	Njësia	Pogradec, Buzinas, Udhë ëfishtë, Gërava, Ve, Propishtit, 'Velican, Dar dhas, Tërbinj ë	Tarifat 2023	Mujore	Pogradec, Buzinas, Udhë ëfishtë, Gërava, Propishtit, Velig an, Dar dhas, Tërbinjë 2024	tarifat 2024	mujore	ditore
Tarifa për subjekte tregtimit, shërbimit, kompani celulare	leke/vit	80,000	132,000	11,000	96,000	156,000	5,200	173
Tarifa për subjekte karburant.	leke/vit	96,000	156,000	13,000	115,200	184,800	6,160	205
Tarifa për subjekte bar-restorant hotel, supermarket, uerqimcore me shumicë	leke/vit	96,000	156,000	13,000	192,000	300,000	10,000	333
Tarifa për subjekte furne buke	leke/vit	80,000	132,000	11,000	96,000	156,000	5,200	173
Tarifa për subjekte furne buke me adrese dyesore në Bashkinë Pogradec.	leke/vit	40,000	72,000	6,000	48,000	84,000	2,800	93
Tarifa për qitesi prodhimt (materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit/VI, A).	leke/vit	250,000	387,000	32,250	300,000	462,000	15,400	513
Tarifa për qitesi prodhimt në territorin e qytetit (njësi administrativë/punime mobiliterë parime drurit/punime	leke/vit	150,000	237,000	19,750	180,000	282,000	9,400	313
Tarifa për çdo subjekt ndërtimit/shërbime në ndërtim.	leke/vit	150,000	237,000	19,750	180,000	282,000	9,400	313
Tarifa shpaze: Çdo objekt për ndërtim, në vitin e parë në ekonomitin e zhdëfijës së lehtë	leke/vit/2 vit	30	12,045	1,004	36	12,054	402	13
Tarifa për objekt në ndërtim, infrastrukturave në vitet pesardhës	leke/vit	150,000	237,000	19,750	180,000	282,000	9,400	313
Tarifa për çdo ndërtimtarje SH.A.	leke/vit	150,000	237,000	19,750	180,000	282,000	9,400	313
